


UDHËZUES PËR PËRDORIMIN E PLATFORMËS SË MONITORIMIT

Ky dokument përshkruan në mënyrë të detajuar hapat për regjistrimin, hyrjen dhe përdorimin e sistemit të raportimit në platformën zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë (ERE): <https://monitorimi.ere.gov.al>. Ai synon të ndihmojë operatorët për një përdorim të saktë dhe të sigurt të sistemit.

■ Hapi 1 – Hyrja në platformë

Për të filluar procesin, përdoruesi duhet të hapë një shfletues (Chrome, Edge, Firefox) dhe të vizitojë adresën: <https://monitorimi.ere.gov.al>.

Në faqen kryesore të platformës do të shfaqen dy opsione: “**Hyr**” për përdoruesit ekzistues dhe “**Regjistrohu**” për operatorët e rinj.



■ **Këshillë:** Sigurohuni që faqja të jetë e hapur me protokollin HTTPS për siguri maksimale të të dhënave.

■ Hapi 2 – Regjistrimi i Operatorit (Krijimi i Llogarisë)

Nëse operatori nuk ka ende llogari, duhet të klikojë në butonin “**Regjistrohu**” për të hapur një formular regjistrimi. Në këtë formular, plotësohen me kujdes të gjitha të dhënat e kërkuara:

Fusha	Përshkrimi
Emri i subjektit	Emri zyrtar i kompanisë që regjistrohet
Përdoruesi (Username)	Duhet të përmbajë NIPT-in e kompanisë (p.sh. A12345678B)
Email	Adresa zyrtare e kontaktit
Fjalëkalimi	Zgjidhni një fjalëkalim të fortë me të paktën 8 karaktere
	Sigurohuni që do të plotësoni të gjitha fushat që janë të shfaqura në dritaren që do të shikoni kur të bëni regjistrimin. Fushat me yll janë të detyrueshme.

Pasi plotësohen të dhënat dhe klikohet butoni “**Regjistrohu**”, përdoruesi merr një njoftim që llogaria e tij është në pritje të aprovimit nga ERE. Vetëm pas aprovimit nga administratori i ERE, llogaria bëhet aktive dhe mundëson hyrjen në sistem.

The screenshot shows a registration form for the Energy Regulatory Authority (ERE). The form is titled "Enti Rregullator i Energjisë - Forme Regjistrimi" and features the ERE logo at the top. The form contains the following fields:

- Përdoruesi *
- Fjalëkalimi *
- E-mail *
- Kategori *
- Shteti *
- Emri ligjor kompanisë *
- Forma ligjore *
- Adresa kompanisë *
- Qyteti kompanisë *
- Kodi eic *
- Kodi bic
- Kodi lei
- NIPT *
- Website
- Kodi Zip
- Publikim Informacioni
- Wepage ku janë publikuar info
- Kontakte

At the bottom of the form, there is a blue button labeled "Regjistrohu" and a link labeled "← Identifikohu".

■ Hyrja në sistem (Ndhimesë për përdoruesit)

Pasi llogaria të jetë aprovuar, operatori mund të hyjë në platformë për të kryer veprimet e raportimit dhe monitorimit të aktiviteteve.

■ Udhëzimi për hyrje:

1. Hapni shfletuesin dhe vizitoni adresën: <https://monitorimi.ere.gov.al>
2. Në fushën e **Përdoruesit** shkruani NIPT-in e kompanisë
3. Në fushën e **Fjalëkalimit** vendosni fjalëkalimin e krijuar gjatë regjistrimit
4. Klikoni butonin **“Hyr”** për të hyrë në sistem.

Nëse kredencialet janë të sakta, sistemi do t'ju drejtojë në faqen kryesore (dashboard), ku mund të ngarkoni dokumente, të plotësoni raportime dhe të shikoni njoftime nga ERE.

■ **Këshillë:** Nëse shfaqet mesazhi 'Username ose password i pasaktë', kontrolloni që të mos ketë hapësira ose gabime në vendosjen e kodit.

■ Dalja nga sistemi (Ndhimesë për përdoruesit)

Pas përfundimit të punës në sistem, është e rëndësishme të dilni nga llogaria për të ruajtur sigurinë e të dhënave.

■ Udhëzimi për dalje:

1. Klikoni mbi ikonën e përdoruesit në këndin e sipërm djathtas
2. Zgjidhni opsionin **“Dil”** ose **“Logout”**
3. Në kutinë e konfirmimit që hapet, klikoni **“Po”** për të dalë nga llogaria.

Pas daljes, do të riktheheni në faqen hyrëse të platformës. Kjo praktikë mbron informacionin tuaj dhe parandalon hyrjet e paautorizuara.

■ **Këshillë sigurie:** Mos ruani fjalëkalimet në kompjuterë publikë dhe njoftoni ERE nëse dyshoni për përdorim të paautorizuar.

■ Këshilla teknike dhe sigurie

- NIPT-i i kompanisë shërben si identifikues unik për çdo operator në sistem.
- Procesi i aprovimit nga ERE siguron që vetëm subjektet e licencuara të kenë akses në platformë.
- Platforma përdor protokollin HTTPS për të garantuar sigurinë e komunikimit dhe të dhënave.
- Rekomandohet ndryshimi periodik i fjalëkalimit për të rritur mbrojtjen e llogarisë.

Ky dokument është përgatitur nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE)

Për çdo paqartësi ose asistencë teknike, kontaktoni administratorin e sistemit në adresën:
remit@ere.gov.al